



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Data: 05.05.2026

Drejtuar: “InfoSoft Office” shpk me NIPT: J62426002Q

Adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8.

Tipi i Kontratës: **Kontratë për Mallra**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **Ref-82016-04-15-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Blerje materiale për mirëmbajtjen e moduleve të lodrave**

Kohëzgjatja e kontratës: Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **Data 16.04.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Nr.28 datë 20 Prill 2026**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik, “Infosoft Office” shpk me NIPT-t:J62426002Q

Vlera: *1,562,137.5 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë) lekë pa tvsh*

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat : **Nuk ka nënkontraktor**

2. Operatori ekonomik, “Nexhmedin Sadiku” PF me NIPT-t: L71503044S

Vlera : *1,984,320 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet) lekë pa tvsh*

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

3. Operatori ekonomik, “ERVIN LUZI” PF me NIPT-t:K71707007Q

Vlera:2,000,000 (dy milion) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “ERVIN LUZI” PF me NIPT-t:K71707007Q

Vlera:2,000,000 (dy milion) lekë pa tvsh

për arsyet e mëposhtme:

Në pikën 2.1.2 Operatori ekonomik ofertues në rastin kur është prodhues duhet të paraqesë certifikatat e sigurisë dhe të përdorimit të pajisjeve në ambientet e jashtme dhe të sigurta në përdorim sipas normave Europiane **S SH EN: 1176-1: 2017 (ose ekuivalente)**. Në rastet kur nuk është prodhues, duhet të paraqesë këtë certifikatë nga prodhuesi, Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar certifikatë **S SH EN: 1176-1: 2017 (ose ekuivalente)**.

Në pikën 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2023,2024,2025, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, kurse ky operator ka paraqitur dokumentacion për vitet 2023 dhe 2024 janë të konfirmuar nga autoriteteve përkatëse tatimore kurse viti 2025 nuk është konfirmuar nga autoriteteve përkatëse tatimore.

Në pikën 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë **Autorizim nga Prodhuesi** ose distributor i autorizuar prej tij, i cili merr përsipër të furnizojë ofertuesin me artikujt objekt prokurimi.Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit(nëse autorizimi nuk është në gjuhën shqipe, atëherë duhet të jetë i përkthyer dhe i noterizuar), në këtë rast operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim nga një prodhues mobilier i cili nuk e ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Në pike 2.3.4 mënyre që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **katalogun/et ose fragmente të katalogjeve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi**, në të cilën të tregohen dhe specifikohen të paktën disa nga mallrat që do të ofrohen dhe të dhënat e subjektit, në këtë rast

operatori ekonomik ka paraqitur katalog që është bërë specifikisht për këtë procedurë ku pershkrimi është marrë nga specifikimet e kerkuara dhe imazhet nga mallrat që ofrojnë (ngjashmeria është shumë e vogël e mallrave të katalogut me ato të kerkuara). Ky katalog nuk ka të dhena të prodhuesit por vetëm të Operatorit ekonomik.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat : **Nuk ka nënkontraktor**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, “InfoSoft Office” shpk me Adrese: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej *1,562,137.5 (një milion e pesëqind e gjashtedhjetë e dy mijë e njeqind e tridhjetë e shtatë pike pese)* lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.